

DEKLARATË MBI SHUMËGJUHËSINË NË ARSIMIN E LARTË

Edhe pse ky dokument nuk mund të prodhojë efekte ligjore, propozon një deklaratë për të nxitur angazhimin publik për të kontribuar aktivisht dhe në mënyrë konstruktive në zhvillimin e politikave për multilinguizmin në arsimin e lartë. Deklarata është e hapur për nënshkrim nga ata që kanë të bëjnë me multilinguizmin në një perspektivë teorike dhe të aplikuar, diversitetin gjuhësor dhe respektimin e të drejtave gjuhësore, dhe, në veçanti, (a) institucionet e arsimit të lartë/qendrat kërkimore, organizatat, federatat, shoqatat (me ose pa personalitet ligjor), (b) individët, si anëtarë të institucioneve të sipërpërmendura dhe institucioneve të tjera shoqërore të përfshira aktivisht në temën e gjuhëve në arsim.

PARATHËNIE

Politikat e ndërkombëtarizimit, të cilat prekin një numër në rritje të institucioneve të arsimit të lartë (IIS), si dhe agjensitë politike kombëtare dhe supranacionale, synojnë të përmirësojnë – ose kështu argumentojnë ata – cilësinë e arsimit të lartë, në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar. Në rastin e BE-së, nismat e politikave të ndërkombëtarizimit synojnë të arrijnë një barazi më të madhe midis sistemeve të arsimit të lartë në kontekstin e 'Zonës Evropiane të Arsimit', duke nxitur bashkëpunimin transnacional, partneritetet midis ISS dhe bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare të BE-së për të arritur të krijojnë 'sisteme gjithëpërfshirëse kombëtare të arsimit dhe trajnimit'. Megjithatë, ndërkombëtarizimi ka rezultuar gjithnjë e më shumë në përdorimin e anglishtes si një 'gjuhë akademike', (*English Medium of Instruction, EMI*) dhe 'anglishtizimin' e arsimit të lartë. Pavarësisht nga dëshmitë në rritje të disavantazheve të përdorimit ekskluziv të anglishtes në mësimdhënie, në kërkim të produkte të rrjetëzimit, anglishtja mbështetet gjithnjë e më shumë nga autoritetet kombëtare dhe politikanët, të cilët supozojnë se anglishtja është mjeti për zhvillimin ekonomik, modernizimin dhe komunikimin global. Megjithatë, përdorimi i anglishtes në dëm të gjuhëve zyrtare/kombëtare, si dhe të gjuhëve rajonale ose të pakicave, mund të çojë në braktisjen e përdorimit të tyre në fusha specifike dhe në mosnjohjen e të drejtave gjuhësore. Për më tepër, përdorimi i anglishtes në kurriz të gjuhëve të tjera, qofshin ato që zotërojnë apo nuk kanë kapital kulturor të rëndësishëm, ka efekte në diversitetin gjuhësor dhe kulturor, duke rezultuar në varfërimin e njohurive në nivel social dhe epistemologjik.

DEKLARATA E PËRGJITHSHME

Nënshkruesit e "Deklaratës mbi Multilinguizmin në Arsimin e Lartë", hartuar nga Platforma Evropiane e Shoqërisë Civile për Multilinguizmin (ECSPM), mbështesin parimet themelore të "Nismës së Helsinkit mbi Multilinguizmin në Komunikimin Akademik" dhe ¹ angazhohen për të kontribuar në vendimet e politikave dhe zgjedhjet e aplikimit që:

- të mbrojnë dhe të mbështesë përdorimin e gjuhëve të shumta përveç gjuhës zyrtare të ISS në qeverisje, në kërkime dhe botime, mësimdhënie-mësim dhe komunikim;

¹ Më poshtë është një përmbledhje e Nismës së Helsinkit mbi Multilinguizmin (<https://www.helsinki-initiative.org/it>):

(1) Të mbështesim shpërndarjen e rezultateve të kërkimit në dobi të plotë të shoqërisë duke siguruar që: a) studiuesit të njihen për shpërndarjen e rezultateve të kërkimit përtej akademisë dhe për ndërveprimin me trashëgiminë, kulturën dhe shoqërinë, dhe b) të sigurohet qasje e barabartë në rezultatet e kërkimit në një sërë gjuhësh; (2) Të mbrojnë infrastrukturën kombëtare për botimin e kërkimeve lokale përkatëse duke siguruar që: a) botuesit jofitimprurës të revistave dhe librave të kenë burime dhe mbështetje të mjaftueshme për të ruajtur standardet e larta të kontrollit të cilësisë dhe integritetit të kërkimit, dhe b) botuesit kombëtarë jofitimprurës të revistave dhe librave të mbrohen në kalimin e tyre në qasje të hapur; (3) Të promovojë diversitetin gjuhësor në sistemet e vlerësimit dhe financimit të kërkimit duke siguruar që: a) në procesin e vlerësimit të ekspertëve, të vlerësohet kërkimi me cilësi të lartë pavarësisht nga gjuha e botimit ose kanalit të botimit, dhe b) kur përdoren sisteme, botime revistash dhe librash me bazë metrike në të gjitha gjuhët janë marrë në konsideratë në mënyrë të përshtatshme.

- të mbrojnë dhe të forcojnë multilinguizmin, në veçanti në mësimdhënie dhe mësim, bashkëpunimin dhe komunikimin transnacional të kërkimit;
- Mbështetje në përdorimin e mjeteve dhe teknologjive gjuhësore për aktivitete mësimore dhe mësim që lehtësojnë përdorimin e gjuhëve të ndryshme.

SENSIBILIZIM

Nënshkruesit e Deklaratës së ECSPM-së mbi Multilinguizmin në Arsimin e Lartë ndërmarrin të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve universitare, si dhe në bërjen e përgjegjësve për politikën gjuhësore, planifikimin e gjuhës dhe zhvillimin e kurrikulave, drejtuesit e njësive kërkimore, studiuesit, studiuesit, studentët, personelin mësimor dhe administrativ dhe shoqërinë civile të vetëdijshëm për faktin se:

- 1) Kompetenca në gjuhën zyrtare/kombëtare, në gjuhën e vet të origjinës ose në gjuhën e folur në shtëpi, ose në ndonjë gjuhë tjetër, mund të mos jetë e mjaftueshme për të garantuar zhvillimin e aftësive të shkrim-leximit akademik që përfshijnë praktika diskursive shumë të ndryshme nga ato që përdoren në praktikën e përditshme gjuhësore. Megjithatë, si zotërimi i të dyjave, si nga nxënësit, ashtu edhe nga mësuesit, është i rëndësishëm për ndërtimin e kuptimit në kontekstet arsimore.
- 2) Kur mësoni ose studjoni në një gjuhë tjetër përveç tuajën, nuk mund/nuk duhet të prisni që qëllimi të arrihet për të qenë një varietet amtare të kësaj gjuhe.
- 3) Është e rëndësishme që studentët dhe stafi universitar të inkurajohen të përdorin të gjitha gjuhët dhe varietetet gjuhësore që kanë në repertorin e tyre për komunikim kuptimplotë në kontekste të ndryshme të jetës së tyre akademike.

REKOMANDIME SPECIFIKE

Nënshkruesit e Deklaratës së ECSPM-së për Multilinguizmin në Arsimin e Lartë bëjnë rekomandimet e mëposhtme që do të miratohen nga politikanët, organizatat transnacionale, kombëtare ose shtetërore, agjencitë, universitetet, qendrat kërkimore, financuesit e kërkimit dhe studiuesit:

1. Ofroni mundësinë për të përdorur disa gjuhë (jo vetëm anglisht) si mjet mësimi në programe, kurse dhe module, krahas gjuhës zyrtare të institucionit.
2. Ka shumë gjuhë "të padukshme" në të gjitha institucionet arsimore. Këtyre duhet t'u jepet mundësia të bëhen të dukshme dhe të njihen.
3. Ofroni mundësinë për të zgjedhur cilën gjuhë të përdorni, duke respektuar garancinë e cilësisë së arsimit.
4. Të sigurohet që mësuesit që ofrojnë kurse në gjuhë të tjera përveç gjuhëve zyrtare të institucionit kanë kompetencë epistemologjike në këto gjuhë.
5. Studentët ndërkombëtarë duhet të ndihmohen për t'u integruar në komunitetin akademik dhe në këtë mënyrë të ofrojnë mundësi mbështetjeje dhe kurse intensive të gjuhës.
6. Shmang përvojat ekskluzivisht monolingual/monokulturor arsimor (p.sh. sigurojnë bibliografi, mjete teknologjike gjuhësore, video në gjuhë të ndryshme).
7. Grupet kërkimore nga universitete të ndryshme duhet të inkurajohen për të zgjidhur gjuhën ose gjuhët që do të përdorin në kohë të ndryshme (gjatë ndërveprimit, shpërndarjes së rezultateve të kërkimit, publikimit të rezultateve).
8. Inkurajoni përkthimin dhe përdorimin paralel të gjuhëve dhe investoni në mjetet e teknologjisë gjuhësore.

Përkthyer nga: Anila Dorda
Mjetet e përkthimit të përdorura: WordReference